



# Newsletter

## Prill- Qershor 2021

**Korrik 2021**

Universiteti "Isa Boletini"- Mitrovicë

Rr.Ukshin Kovaçica, 40000 Mitrovicë

+383 (028) 535 726

info@umib.net | [www.umib.net](http://www.umib.net)



## U mbajt konferenca “Bashkëpunimi Universitet – Industri”

06.04.2021


Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), u mbajt të martën konferenca shkencore “Bashkëpunimi Universitet – Industri”, organizuar nga Qendra për Inovacion dhe Ndërmarrësi. Në këtë konferencë e cila mbahet online për shkak të pandemisë Covid-19, do të paraqiten gjithsej 12 prezantime.

Drejtori i Qendrës për Inovacion dhe Ndërmarrësi, Besart Hajrizi, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në konferencë, të cilët me punimet e tyre kanë kontribuar në identifikimin e mundësive dhe problemeve sa i përket bashkëpunimit ndërmjet universitetit dhe industrisë. Ai shprehu kënaqësinë që në mesin e atyre që janë paraqitur me punime, përveç tjerëve, ka asistentë dhe studentë, që janë bërë pjesë e kësaj konference.

Ndërsa, rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, ka përgëzuar organizatorët e konferencës dhe pjesëmarrësit që janë paraqitur me prezantimet e tyre. “UIBM, si një institucion i ri po e konkretizon përvojën e gjatë në arsimin e lartë si një universitet ndërmarrës, duke ndërlidhë kështu ngushtë hulumtimin universitar me aktivitetet e tregut”, tha ai.

Sipas tij, Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, e themeluar dy vite më parë në UIBM, ka për qëllim intensifikimin e aktiviteteve për hulumtim dhe zhvillim, e që mund të shërbejë si bazë e qëndrueshme për gjenerimin e ideve dhe zhvillimin e tyre nga të rinjtë dhe të rejtat e Republikës së Kosovës. “Përveç Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Universiteti “Isa Boletini”, themeloi edhe Bordin Industrial që sot ofron universitetin me industrinë dhe lehtëson në masë të madhe harmonizimin e nevojave që ka industria për staf të kualifikuar dhe përgatitjes së këtij resursi intelektual nga ana e universitetit”.

Në hapje të konferencës, një fjalë rasti e ka mbajtur edhe Visar Idrizi nga Bordi Industrial, ndërsa më pas kanë filluar prezantimet.





**Rektori Musaj ngushëllon familjen, miqtë dhe kolegët për të ndjerin, prof.dr.  
Blerim Baruti**

12.04.2021

Të nderuar familjarë të profesorit të ndjerë, prof.dr. Blerim Baruti

Të nderuar miq dhe kolegë të të ndjerit

Ju lutem të pranoni ngushëllimet më të sinqerta në emrin tim personal dhe në emër të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, për ndarjen nga jeta të familjarit tuaj si dhe mikut dhe kolegut tonë, prof.dr. Blerim Baruti. Lajmi për vdekjen e tij, përveç familjarëve na ka pikëlluar jashtëzakonisht shumë edhe neve si bashkëpunëtorë dhe kolegë.

Ai ka lënë emër të mirë në secilën pozitë që ka mbajtur, ndërsa si profesor do të kujtohet si një pedagog tepër i përkushtuar dhe bashkëpunues. Profesori Blerim do të na mungoj të gjithëve fizikisht, por puna, sjellja dhe korrektësia e tij do të na shërbej si frymëzim.

Qoftë i përjetshëm kujtimi për profesorin, Blerim Baruti.

Me respekt

Rektori

Prof.dr. Alush Musaj





**Universiteti “Isa Boletini” bashkëorganizator i “Konferencës së 3-të Ndërkombëtare të Konkurrencës Globale dhe Menaxhimit të Inovacionit” në Stamboll**

14.04.2021

Konferenca e 3-të Ndërkombëtare e Konkurrencës Globale dhe Menaxhimit të Inovacionit do të mbahet më 16-19 Shtator 2021, në Stamboll. UIBM do të jetë bashkëorganizator i kësaj Konference, dhe do të marrë pjesë në cilësin e Keynote Speaker, Kryesuesve të Sesioneve të Konferencës dhe anëtar të Komitetit Shkencor.





## **Rektori Musaj ngushëllon familjen dhe miqtë për ndarjen nga jeta të prof.dr.Behajdin Skeja**

**14.04.2021**

**Me hidhërim e kemi pranuar lajmin për ndarjen nga jeta të prof.dr. Behajdin Skeja, i cili për shumë vite ka punuar si mësimdhënës në ish-Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë, tash Fakultetit të Gjeoshkencave në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë. Të nderuar familjarë, miq dhe kolegë të profesorit të ndjerë, prof.dr. Behajdin Skeja, ju lutëm të pranoni ngushëllimet më të sinqerta në emrin tim dhe në emër të Universitetit “Isa Boletini”.**

**Profesor Skeja, përveç familjarëve do të kujtohet edhe nga ish-studentët, miqtë dhe kolegët e tij për vlerat e tij njerëzore dhe profesionale. Do të kujtohet si një personalitet që ka lënë gjurmë me punën e tij akademike dhe shkencore.**

**Qoftë i përjetshëm kujtimi për prof.dr. Behajdin Skeja**

**Me respekt**

**Rektori**

**Prof.dr. Alush Musaj**





## Profesori nga Tirana, prof.dr. Angjelin Shtjefni, dhuron libra për UIBM


19.04.2021

Profesori i Universitetit Politeknik në Tiranë, prof.dr. Angjelin Shtjefni, ka dhuruar katër libra nga fusha e fizikës për Fakultetin e Teknologjisë Mekanike dhe Kompujterike (FIMK) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Këto libra janë dërguar në emër të dekanit të FIMK-ut, prof.dr. Hakif Zeqiri, i cili e ka falënderuar profesorin, Shtjefni për donacionin.

Dekani Zeqiri, tha se librat do të jenë në dispozicion të studentëve dhe mësimdhënësve të FIMK-ut dhe gjithë Universitetit. “Ne kemi nevojë për pasurimin e fondit librar në institucionin tonë akademik dhe presim mbështetje nga profesorët, njerëzit e dijes dhe shkencës në këtë drejtim”, tha ai.

Dhurimi i librave për Bibliotekën Universitare tashmë ka nisur të shndërrohet në një praktikë të mirë. Ditë më parë, në kuadër të shënimit të 8-vjetorit të themelimit të UIBM ka nisur edhe aksioni për dhurimin e librave për këtë bibliotekë.

Poashtu në kuadër të të njëjtit përvjetor është promovuar Biblioteka Universitare me qasje të hapur për të gjithë komunitetin dhe jo vetëm për studentët. Si rrjedhojë fondin e Bibliotekës Universitare do të mund ta shfrytëzojnë të gjithë qytetarët pa përjashtim.





## UIBM del i dyti pas UP-së sa i përket “Integritetit akademik, publikimit shkencor dhe justifikimit të titujve akademikë”


23.04.2021

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UBIM) është renditur i dyti pas Universitetit të Prishtinës, sa i përket “Integritetit akademik, publikimit shkencor dhe justifikimit të titujve akademikë”. Kjo është bërë e ditur nga raporti i organizatës ORCA që është prezantuar të premten në Prishtinë.

Drejtori i ORCA-së, Rron Gjinovci, tha se janë befasuar me të gjeturat për UIBM, që në shumicën e indikatorëve ka dalur e dyta e herë e para në krahasim me universitetet tjera. Sipas tij, raporti është rezultat i punës hulumtuese gjatë periudhës kohore janar-shkurt 2021, ku hulumtuesit e ORCA-s shqyrtuan materialet e publikuara në CV-të e stafit akademik me titujt profesorial: profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt.

Sipas raportit, në UIBM ka 3.61 punime për kokë profesori, ndërsa ngjashëm me universitetet e tjera publike, por dukshëm në përqindje më të vogël, 48% e profesorëve në UIBM nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë. Për krahasim, mosjustifikimi i titujve për vitin 2020 në Universitetin e Gjakovës është 65%, ndërkohë që gjatë vitit 2019, mosjustifikimi i titujve në Universitetin e Prishtinës ishte 55%, në Universitetin e Prizrenit ishte 64% dhe në Universitetin e Pejës ishte 70%.

Sa i përket, publikimit në revista të dyshimta, rektori, Alush Musaj, sqaroi se kjo përqindje ka dalur për shkak se matjet janë bërë me të njëjtat kritere edhe për vitet e mëhershme, kur për avancimin është kërkuar vetëm një publikim në një revistë të huaj, ndërsa prej vitit 2018 ka hyrë në fuqi Udhëzimi i ri Administrativ i MASHT-it dhe Rregullorja e UIBM-së. Rektori, shprehu kënaqësinë që përkundër sfidave në përgjithësi ka dalur një raport që flet për ngritje të punës së mirëfilltë shkencore në UIBM.






## Abdullah Begolli ndihmon me libra Bibliotekën Universitare

27.04.2021

Abdullah Begolli, ka dhuruar pesë kopje të librit, “Energjia”, për Bibliotekën Universitare në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë. Libri, i cili përmban analiza, informacione, fakte të nxjerra nga burime të ndryshme, ofron një mundësi të mirë për studentët dhe mësuesit që kanë interesim për prodhimin e energjisë.

Librat i ka pranuar dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (FIMK), prof.dr. Hakif Zeqiri, i cili e ka falënderuar autorin për këtë donacion. “Po shohim një interesim të shtuar të njerëzve të dijes dhe shkencës për t’i ndihmuar studentët tanë me botimet e tyre shkencore”, tha ai.

Përndryshe, prej marsit të këtij viti vazhdon të jetë i hapur aksioni për dhurimin e librave për Bibliotekën Universitare, përderisa në të njëjtën kohë ajo është shpallur e hapur për të gjithë të interesuarit.





## Studentët e UIBM votojnë për përfaqësuesit e tyre në Këshillat Studentore dhe Parlamentin Studentor

27.04.2021

Studentët e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) janë duke votuar sot (27 prill 2021), për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në Këshillat Studentore nëpër njësi akademike si dhe për Parlamentin Studentor. Në garë janë tri organizata studentore: “Fjala Studentore”, “Zëri Studentor” dhe “Koha Studentore”, ndërsa të drejtë vote kanë 2113 studentë të gjashtë fakulteteve në kuadër të UIBM.

Kryetari i Komisionit Qendror Zgjedhor, Arbnor Ajeti, tha se përgatitjet janë bërë me kohë dhe procesi i votimit po shkon mirë dhe pa asnjë problem. “Përgatitjet për zgjedhjet e studentëve janë bërë si duhet dhe ato janë organizuar duke respektuar edhe masat parandaluese në kuadër të mbrojtjes nga Covid-19”, tha ai.

Sipas tij, gjashtë qendrat e votimit janë hapur me kohë në orën 08:00 dhe do të mbyllen në orën 17:00. “Procesin e votimit e ka monitoruar edhe kryetari i Këshillit Komunal të Zgjedhjeve, Bajram Hajdari, me bashkëpunëtorë”, të cilët edhe kanë asistuar në organizimin e këtyre zgjedhjeve”, theksoi Ajeti.






## UIBM fitues i projektit në kuadër të EU4TECH PoC Western Balkans 2021

28.04.2021

Projekti EU4TECH PoC WB <https://eu4tech.eu/> ofron mbështetje të specializuar për 40 nga projektet më premtuese të bazuara në teknologji të zhvilluara brenda organizatave kërkimore publike dhe ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme nga Ballkani Perëndimor në 'Proof of Concept Stage'.

Në thirrjet që ishin në Janar-Shkurt 2021, UIBM ka aplikuar me projektin "In-SITU Modeling and thermodynamic calculation of Ferro-Nickel alloys for top products", bartës i të cilit është Phd. Kandidati Bastri Zeka, Asistent në Departamentin Materiale dhe Metalurgji ne fakultetin e Gjeoshkencave. Projekti është pranuar dhe tani gjendet në fazën e hartimit të planit të veprimit, për zhvillimin e këtij projekti.





## **Të premtën (30 prill 2021) nënshkruhet Memorandum Bashkëpunimi me HERAS-in**

**28.04.2021**

Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), do të mbahet të premtën (30 prill 2021), një takim promovues për Raportin “Baseline Assessment”, ku gjithashtu do të diskutohet për procedimin e aplikacionit për mbështetje bazuar në instrumentin “Earmared Fund” si dhe do të nënshkruhet edhe një Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet UIBM dhe HERAS-it.

Në këtë aktivitet që mbahet në hapësirat e Rektoratit prej orës 10:00, duke respektuar protokollet për mbrojtje nga COVID-19, do të organizohet edhe një video – lidhje përmes me ekspertët austriak të projektit. Përveç menaxhmentit të UIBM dhe drejtuesve të HERAS-it, pritet të marrin pjesë edhe përfaqësues nga Zyra në Prishtinë e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).





## U prezantua raporti i HERAS-it “Vlerësimi bazë” për UIBM

30.04.2021

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) është në rrugë të mbarë të zhvillimit dhe arritjes së standardeve që e bëjnë një institucion kredibil akademik. Kështu u vlerësua të premten me rastin e prezantimit të raportit “Vlerësimi bazë” të përgatitur nga ekspertët e HERAS-it.

Fjolla Kaçaniku, eksperte e angazhuar në këtë projekt, tha se në përgatitjen e vlerësimit për UIBM janë marrë për bazë shtatë fusha: 1. Planifikimi dhe orientimi strategjik, 2. Sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë, 3. Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe mobiliteti, 4. Zhvillimi i kërkimit dhe inovacioni, 5. Mësimdhënia dhe të nxënit, 6. Rëndësia e lidhjes me tregun e punës dhe 7. Dimensionet gjinore dhe të drejtat e njeriut.

Sipas saj, në të gjitha fushat është vërejtur përmirësim i ndjeshëm që tregojnë për punë dhe angazhim në këtë institucion akademik. “Për të gjitha fushat e hulumtimit janë dhënë vlerësimet dhe rekomandimet në raportin e përgatitur”, tha ajo.

Rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, falënderoi përfaqësuesit e HERAS-it për mbështetjen e vazhdueshme që ofrojnë. “Jemi shumë të kënaqur me bashkëpunimin që kemi me HERAS-in dhe gjithashtu vlerësojmë Raportin “Vlerësimi bazë” që është përgatitur për UIBM”.

Një fjalë rasti e ka mbajtur edhe udhëheqësja e Zyrës austriake për zhvillim dhe bashkëpunim, Sandra Horina dhe udhëheqësi i projektit HERAS, Aqim Emurli, përderisa me nëpërmjet videolidhjes ka folur për projektin edhe Louise Sperl nga WUS Austria. Ndërsa, prorektorja për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Zhvillim të Cilësisë, mbajti një fjalë rasti për Bashkëpunimin midis UMIB dhe HERAS + përmes “Earmared Fund”.

Në fund rektori Musaj dhe udhëheqësi i projektit HERAS, Aqim Emurli, nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet UIBM dhe HERAS-it.






## U mbajt WorkShop-i i parë ndërkombëtar në kuadër të projektit “Dual Curricula – Study and Work Practice in Agriculture and Food Safety”

05.05.2021

Me datën 16.04.2021 u mbajt WorkShop-i i parë ndërkombëtar në kuadër të projektit “Dual Curricula – Study and Work Practice in Agriculture and Food Safety” nga programi Erasmus +. I gjithë workshop-i u realizua online, pjesëmarrës në workshop ishin stafi akademik i institucioneve partnere anëtar të Alumni-t të secilit institucion, dhe partnerët tjerë jo akademik.

Gjatë këtij workshop-i, Universitetet partnere nga Gjermania, Finlanda dhe Shqipëria prezantuan eksperiencat e tyre me programet e dyfishta të studimit, ndërsa Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti Isa Boletini në Mitrovicë prezantuan eksperiencat e studimit të orientuar drejt praktikës.

Përfaqësuesit e këtij projekti nga radhët e UIBM nga Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore pjesëmarrës ishin Bahtir Hyseni, Arbër Hyseni, Dafina Llugaxhiu dhe Shpend Doli. Përfaqësuesit e FTU në këtë projekt ndanë me të pranishmit eksperiencat rreth projekteve tashmë të realizuara nga FTU. Këto projekte për qëllim kanë pasur ngritjen e kapaciteteve dhe njohurive praktike për student. Ndër projektet e përmendura ishin Projekti “EcoDairy” në bashkëpunimi me Van Hall Larinsten University, dhe projekti “Izolimi i bakteve Bacillus nga mostra dheu për prodhimin e enzimës proteazë nga mbetjet e Industrisë Ushqimore” I financuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. Si shembull konkret, studentja Ylberinë Baliu ndau me të pranishmit eksperiencat e saj me pjesëmarrjen në këto projekte ndërtimin e njohurive dhe përfitimin në aspektin profesional dhe karrierë.






## Mirënjohje për drejtorin e AKSP-së, Arton Berisha

12.05.2021

Drejtori i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP), Arton Berisha, është nderuar me mirënjohje nga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), për mbështetjen e ofruar gjatë procesit të ri-akreditimit të programeve akademike. Në emër të rektorit, prof.dr. Alush Musaj, mirënjohjen ia ka dorëzuar Zyrtari i Lartë për Sigurim të Cilësisë, Elvis Feka.

Në takimin që u mbajt në selinë e AKSP-së në Vushtrri, Feka, falënderoi drejtorin Berisha për mbështetjen gjatë procesit të ri-akreditimit të programeve akademike në UIBM. “Duke pasur parasysh natyrën akademike të institucioneve tona, kemi hasur në mbështetjen tuaj për çka jemi shumë mirënjohës”, tha ai.

Ndërsa, drejtori Berisha, shprehu gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat që ndërlidhen me kapacitetet që kanë në posedim. “ Jemi të lumtur që UIBM po kalon me sukses procesin e ri-akreditimit dhe që sado pak kemi mundur t’ju mbështesim”, tha ai.





## Urimi i rektorit, prof.dr. Alush Musaj, për Fitër Bajram

12.05.2021

Të nderuar studentë, mësime dhe punëtorë të administratës në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, si dhe të gjithë ju qytetarë të besimit islam, më lejoni t’ju uroj Fitër Bajramin. Pas muajit të madhërisëm të Ramazanit, muajit të devotshmërisë dhe solidaritetit, bëhemi bashkë në familjet tona për të festuar dhe çmuar njëri – tjetrin.

Bëhemi bashkë për t’i harruar për një moment hallet e përditshme dhe për t’u ndje të plotë pranë njerëzve, të cilët i kemi afër e larg. Festojmë në vendin tonë të lirë, në shtetin tonë, me familjet dhe miqtë tanë dhe jemi mirënjohës Zotit dhe njerëzve që sakrifkuan për ne! Urime!

Me respekt

Rektori

Prof.dr.Alush Musaj





## Është mbajtur workshop-i EU4TECH PoC : IP Strategy Workshop, për projektin e parë të fituar nga UIBM në kuadër të projekteve “Proof of Concept”

14.05.2021

Është mbajtur workshopi i parë me 11 institucione në POC ku UIBM është përfaqësuar me INSITU-MTC University of Mitrovica me temën për strategjinë dhe zhvillim të projektit: IP Strategy Workshop update and advanced reading, me të cilën në 5 javët e ardhshme do të zhvillohen edhe individualisht në ndërtimin dhe zhvillimin e projektit.

Institucionet pjesëmarrëse ishin:

Smart TTI      University “Mother Teresa” Skopje

INSITU-MTC    University of Mitrovica

Modular camera-  
Amaturn

Chodex Studio LTD

InnoPod      Fixigo DOO

RIC engine    FRONTIS d.o.o.


S-watch University of Montenegro

Green key      Faculty of Agriculture  
Sciences and Food UKIM

ACLEMETH    Goce Delcev University  
Stip

GenWells      Genlajt DOOEL

Guidi    Ortačko Društvo Guidi,





## Vizitë prezantimi të UIBM-FGJ në shkollat e mesme të Vushtrrisë

20.05.2021

Sot më 19.05.2021 stafi i UIBM Fakulteti i Gjeoshkencave Prof. Kemajl Zeqiri, Ass. Ujmir Uka si dhe dy studente të nivelit Master vizituan maturantët e shkollave të mesme SHMT “Lutfi Musiqi”, SHMP “Bahri Haxha” si dhe Gjimnazi “Eqrem Çabej në Vushtrri.

Në kuandër të vizitës promovuese nxënësit u informuan rreth mundësive të studimit në departamentet e Fakultetit të Gjeoshkencave, mundësive të bashkëpunimit me Universitet e huaja që UIBM ofron si dhe mundësitë e zhvillimit profesional për tregun e punës.





## Mirënjohje për drejtorin e Akademisë për Drejtësi, Enver Fejzullahu

20.05.2021

Drejtori ekzekutiv i Akademisë për Drejtësi, Enver Fejzullahu, është nderuar me mirënjohje nga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UBIM) për mbështetje në procesin e ri-akreditimit të programeve akademike. Mirënjohjen në emër të rektorit, prof.dr. Alush Musaj, ia dorëzoi drejtori për Informim dhe Komunikim me Publikun, Ahmet Jashari dhe zyrtari i Lartë për Cilësi, Elvis Feka.

Përfaqësuesit e UIBM e falënderuan drejtorin Fejzullahu për mbështetjen që ka ofruar institucioni që ai drejton në procesin e ri-akreditimit të programeve akademike. U vlerësua jashtëzakonisht qasja konstruktive sa i përket bashkëpunimit në të mirë të ngritjes së performancës institucionale.

Në këtë kontekst u përmenden edhe rezultatet pozitive në procesin e ri-akreditimit të programeve në UIBM. Të dy palët shprehën vullnetin për themelimin e bashkëpunimit me interes reciprok për të dy institucionet






## Tre studentë të Ekonomikut presin të vazhdojnë studimet në një universitet teknik në Poloni

24.05.2021

Tre studentë të Fakultetit Ekonomik (FE) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), ju kanë nënshtuar testeve të nevojshme për të fituar të drejtën që të vazhdojnë studimet për një semestër në “West Pomeranian University of Teknology” në Poloni. Kjo mundësi për studentët e UIBM ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit ndëruniversitar në kuadër të projektit Erasmus+.

Studentët e Ekonomikut: Ariona Rushiti, Arlinda Sherifi dhe Rrezon Haziri, kanë kaluar fillimisht testin e gjuhës angleze dhe janë në proces të kompletimit të dosjeve me dokumente për regjistrimin e semestrit në “West Pomeranian University of Teknology”. Ata janë shprehur të lumtur që ju ka ofruar kjo mundësi dhe shpresojnë shumë që të realizojnë synimet e tyre.

Drejtuesit e UIBM-së vazhdimisht i kanë inkurajuar studentët dhe mësimitdhënësit që të bëhen pjesë e këtyre projekteve që ofrohen nëpërmjet programit Erasmus+, apo organizatave të tjera.






## Universitetit “Isa Boletini” të Mitrovicës i shtohen edhe dy Doktorë të Shkencës

24.05.2021

Profesoresha e fakultetit Ekonomik, Filloreta Demiri, më 27.04.2021, ka mbrojtur me sukses temën e doktoratës, me titull: “The Role of the Banking System in the Development of SMEs – Comparative analysis between Kosovo and Macedonia”, në mentorimin e Prof. Dr. Nadine Tournois, profesoreshë në University Cote D’Azur, Nice, Francë.

Profesori i fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, Bahtir Hyseni, më 20.5.2021, ka mbrojtur me sukses temën e doktoratës, me titull: “Production of Enzymes for Food Industry via Solid-State Fermentation and Optimization of Process Conditions”, në mentorimin e Assist Prof. Dr. Emrah Nikerel.





## Vazhdon fushata informuese për të studiuar në FGJ

25.05.2021

Në vazhën e fushatës informuese për programet që ofron Fakulteti i Gjoeshkencave (FGJ) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) si dhe punës praktike dhe mandej punësimin në kompaninë “Ferronikel”, janë mbajtur takime me nxënësit e shkollave të mesme të Drenasit. Për programet e studimeve në FGJ folën prof.asoc.Zarife Bajraktari-Gashi, ass.Arbër Zeqiraj, ass.Ujmir Ujkani dhe studentja e nivelit master, Elona Qerimi, ndërsa kompaninë e “Ferronikelit”, msc.inxh.Behram Halilaj.


Ditë më parë aktivitete të tilla për informim e të rinjve për mundësitë që ofrohen për të studiuar në FGJ u mbajtën edhe me nxënësit e shkollave të mesme të Vushtrrisë, përderisa në ndërkohë gjatë këtyre ditëve Qendra për Zhvillim të Karrierës do të organizoj takime informuese në të gjitha shkollat e mesme të Mitrovicës, Skenderajt dhe Vushtrrisë.





# Programet e studimit për vitin akademik 2021/2022

25.05.2021



VITI AKADEMIK 2021/2022



KAMPUS  
MODERN



BURSA  
UNIVERSITARE



MUNDËSI  
PUNËSIMI

KAMPUSI UNIVERSITAR

Web: [www.umib.net](http://www.umib.net)

Email: [info@umib.net](mailto:info@umib.net)

Facebook: [Universiteti "Isa Boletini"- Mitrovicë](https://www.facebook.com/Universiteti-Isa-Boletini-Mitrovica)

Rr. Ukshin Kovaçica, p.n



## FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE

### BACHELOR

- 1.XEHETARI
2. GJELOGJI
3. MATERIALE DHE METALURGJI  
(ME SPECIALIZIME:  
MATERIALE; METALURGJI)

### MASTER

- 1.XEHETARI
- 2.HIDROGJELOGJI DHE GJELOGJI  
INXHINIERIKE
- 3.VENDBURIMET E LENDËVE TË PARA  
MINERALE
- 4.MATERIALE
- 5.METALURGJI

## FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE

### BACHELOR

1. TEKNOLOGJI  
(INXHINIERI MJEDISORE,  
INXHINIERI KIMIKE)
2. INXHINIERI DHE TEKNOLOGJI  
USHQIMORE

### MASTER

1. TEKNOLOGJI (INXHINIERI E  
MBROJTJES MJEDISORE, INXHINIERI  
KIMIKE)
2. INXHINIERI DHE TEKNOLOGJI  
USHQIMORE

## FAKULTETI I INXHINERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE

### BACHELOR

1. SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI
2. INXHINIERI EKONOMIKE
3. MAKINERI PRODHUESE

### MASTER

1. INXHINIERI EKONOMIKE

## FAKULTETI JURIDIK

### BACHELOR

1. JURIDIK

## FAKULTETI EKONOMIK

### BACHELOR

1. BIZNES DHE MENAXHMENT (BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET)

## FAKULTETI I EDUKIMIT

### BACHELOR

1. EDUKIM FILLOR



## Vazhdon fushata informuese për të studiuar në FGJ

25.05.2021

Në vazhdën e fushatës informuese për programet që ofron Fakulteti i Gjoeshkencave (FGJ) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) si dhe punës praktike dhe mandej punësimit në kompaninë “Ferronikel”, janë mbajtur takime me nxënësit e shkollave të mesme të Drenasit. Për programet e studimeve në FGJ folën prof.asoc.Zarife Bajraktari-Gashi, ass.Arbër Zeqiraj, ass.Ujmir Ujkani dhe studentja e nivelit master, Elona Qerimi, ndërsa kompaninë e “Ferronikelit”, msc.inxh.Behram Halilaj.

Ditë më parë aktivitete të tilla për informim e të rinjve për mundësitë që ofrohen për të studiuar në FGJ u mbajtën edhe me nxënësit e shkollave të mesme të Vushtrrisë, përderisa në ndërkohë gjatë këtyre ditëve Qendra për Zhvillim të Karrierës do të organizoj takime informuese në të gjitha shkollat e mesme të Mitrovicës, Skenderajt dhe Vushtrrisë.





## Nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike njoftohen për programet e studimit të UIBM

25.05.2021

Një grup studentësh të udhëhequr nga zyrtari i Qendrës për Zhvillim të Karrierës në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), Alban Fazliu, kanë zhvilluar të martën një takim me nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë, ku kanë prezantuar programet e studimit për vitin akademik 2021/22. Nxënësit janë informuar në detaje për kushtet e studimit, kampusin modern, kabinetet dhe laboratorët, bursat universitare etj.

Gjithashtu atyre ju është bërë e ditur se programet që ofrohen në UIBM janë shumë atraktive në tregun e punës. U përmenden edhe bashkëpunimet që ka UIBM me universitetet gjithandej nëpër Evropë, ku ofrohen mundësi për vazhdimin e studimeve.

U potencua se UIBM është një institucion i konsoliduar akademik, i cili megjithëse ka vetëm 8 vjet prej themelimit në çdo matje sa i përket performancës akademike renditet i dyti në nivel vendi për Universitetit të Prishtinës. Në këtë kontekst u përmend ranglista e webometrix si dhe hulumtimi për punën kërkimore nga organizata ORCA.





## Takime informuese me maturantët e “Gjimnazit” dhe “Ekonomisë”

26.05.2021

Grupi i udhëhequr nga Qendra për Zhvillim të Karrierës ka vazhduar edhe të mërkurën aktivitetet në kuadër të fushatës informuese për programet dhe kushtet që ofron për studim Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Takime të tilla janë mbajtur me nxënësit e Gjimnazit “Frang Bardhi” dhe ata të Shkollës së Mesme Ekonomike “Hasan Prishtina”.

Të enjten janë planifikuar takime me nxënësit e Shkollës së Mjekësisë “Xheladin Deda” në Mitrovicë, përderisa ditët në vazhdim fushata informuese do të shtrihet edhe në shkollat e mesme të Skenderajt dhe Vushtrisë. Përveç diskutimeve me maturantë, nëpër shkolla po shpërndahen edhe fletushka dhe materiale tjera informuese për programet e studimit, kampusin, punën praktike, mundësitë e punësimit etj.





## Takime me maturanët e “Mjekësisë” në Mitrovicë dhe ata të Shkollës Teknike Profesionale në Vushtrri

27.05.2021

Grupi i studentëve të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) të udhëhequr nga Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) ka vazhduar edhe të enjten takimet informuese me nxënësit e shkollave të mesme. Takime të tilla janë mbajtur me maturanët e Shkollës së Mesme të Mjekësisë “Xheladin Deda” në Mitrovicë dhe me ata të Shkollës Teknike Profesionale në Vushtrri.

Studentët janë njoftuar me mundësitë që ofron UIBM, duke filluar prej programeve të studimit, kampusin, bursat, vazhdimin e studimeve jashtë vendit etj. Gjithashtu ata kanë mësuar për procedurat e aplikimit, kushtet e studimeve dhe provimet pranuese nëpër njësi akademike, duke qenë sa më të përgatitur në kohën e shpalljes së konkursit për pranim në UIBM.





## Marrëveshje bashkëpunimi me OJQ REC – “Reconciliation Empowering Communities”

27.05.2021

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) do të bashkëpunojë me OJQ REC – “Reconciliation Empowering Communities” për çështje me interes reciprok për të dy palët. Për specifikimin e fushave të bashkëpunimit të enjten u nënshkrua edhe një Memorandum Bashkëpunimi nga rektori i UIBM, prof.dr.Alush Musaj dhe drejtori i OJQ REC, Besnik Uka.

Rektori Musaj, tha se qëllimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi, mbështetja dhe bashkërendimi i aktiviteteve në mes të subjekteve të lartcekura. “Memorandumi synon të promovojë përpjekjet e përbashkëta të dy institucioneve në sferën e avancimit të çështjeve me interes reciprok”, tha ai, duke falënderuar drejtuesit e OJQ REC për qasjen e tyre korrekte.

Ndërsa, drejtori Uka tha se nëpërmjet këtij memorandumi palët do të bashkërendojnë aktivitetet për afirmimin e çështjeve aktuale në fushën e avancimit të jetës akademike dhe profesionale përmes: bashkëpunimit në zhvillimin e moduleve dhe programeve të ndryshme të studimit, realizimit të punës praktike për studentët e UIBM. Ai vlerësoi punën e mirë dhe angazhimin e Qendrës për Zhvillim të Karrierës në UIBM për arritjen e bashkëpunimit.

Ndryshe, si fusha tjera të bashkëpunimit janë paraparë shkëmbimet e përvojave, praktikave të mira, ekspertëve dhe literaturës përkatëse për zhvillimin institucional, me qëllim të avancimit profesional dhe akademik të studentëve. Poashtu planifikohet punë e përbashkët për hartimin e programeve hulumtuese dhe kërkimore komform kërkesave dhe interesave dypalëshe, mandej organizimin e përbashkët, të veprimtarive shkencore dhe profesionale si: simpoziume, seminare, konferenca, tryeza, shkolla verore, trajnime etj si dhe ndikimit pozitiv në përafrimin e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës.





## Studentët e UIBM dolën fitues në garën për siguri kibernetike si pjesë e ngjarjes CED Balkans 2021

27.05.2021

Studentët e Departamentit Informatikë Inxhinierike nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (FIMK) të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) ngadhënjyen në garën “Hackathon” të llojit Capture the Flag, të organizuar si pjesë e ngjarjes CED Ballkans 2021 nga organizata CRDF Global më përkrahje nga Departamenti i Shtetit. Gjatë garës pjesëmarrësit duhej të mbronin sigurinë dhe integritetin e një objekti infrastrukturor virtual duke qenë pjesë e një ekipi real të sigurisë kibernetike.

Ngjarja u zhvillua përgjatë dy ditëve, dhe në të morën pjesë dy ekipe nga Universiteti “Isa Boletini” si dhe studentë nga vendet e Ballkanit, përkatësisht Shqipëria, Maqedonia Veriore, Mali i Zi, dhe Bosnjë dhe Hercegovina. Në fund, studentët fitues, Valton Tahiri, Armend Binaku, Eron Mahmuti dhe Fisnik Murati u shpërblyen me kuponë për të ndjekur një nga certifikimet më të njohura në botë për siguri kibernetike Certified Ethical Hacker (CEH).

Gjithashtu këta studentë do ta përfaqësojnë vendin në garën e ardhshme në muajin shator 2021, ku fituesit do të kenë mundësi të shpërblehen me një vizitë studimore në SHBA. Shefi i departamentit, profesori Berat Ujkani, përgëzoi studentët fitues duke shtuar se studentët kanë qenë të motivuar fortë dhe i inkurajoi ata për punë dhe suksese të mëtejme. “Studentët kanë treguar përkushtim dhe vullnet, prandaj ia kanë dalur që të na nderojnë me vendin e parë”, theksoi ai.





## Nënshkruhet marrëveshja e partneritetit në projektin “DualAFS”

28.05.2021

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore (FTU) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), ka filluar implementimin e projektit “DualAFS”, të fituar në kuadër të programit Erasmus+. Pjesë kryesore për konstituimin e projektit është arritja e marrëveshjes multilaterale prej të gjithë partnerëve nga Evropa, Shqipëria dhe Kosova.

Në këtë kontekst, rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, prof.dr.Alush Musaj, ka nënshkruar marrëveshjen e partneritetit në kuadër të këtij projekti. Marrëveshja do të mundësojë vazhdimin e implementimit të projektit në periudhën 2021-2024 përmes të cilit FTU-ja, do të përfitojë pajisje për mësimin në distancë, pajisje laboratorike dhe fuqizojë pjesën praktike për studentët në industritë partnere.

Rektori Musaj, e ka vlerësuar si një projekt shumë të rëndësishëm për FTU-në dhe UIBM në përgjithësi, duke pasur parasysh përfitimet që do të kenë studentët, mësimdhënësit dhe partnerët.





## Universiteti “Isa Boletini” Mitrovicë në bashkëpunimin me Leoben University në Austri fiton një projekt nga HERAS+

02.06.2021

Projekti “Ndërtimi i kapaciteteve kërkimore për hulumtim empirik në fushën e arsimit për të siguruar kohezionin social dhe barazi në sistemin e edukimit në Kosovë”.

Ky projekt synon të mbështesë ndërtimin e kapaciteteve, bashkëpunimin dhe rrjetëzimin për të përmirësuar hulumtimi empirik në fushën e arsimit në Kosovë. Gjatë këtij projektit profesorët dhe asistentët do të kenë mundësi të ndjekin trajnimë për të përmirësuar kompetencat e tyre kërkimore të nevojshme për botim në një audiencë ndërkombëtare. Ky projekt është projekti i parë në Kosovë që do të përqëndrohet në analizën e të dhënave nga prgramet vlerësuese si PISA dhe TIMSS për të mbështetur ndërtimin e politikave arsimore të bazuara në evidencë. Hulumtimet dhe analizat që do të bëhen gjatë këtij projekti do të botohen në një libër, të redaktuar nga koordinatorët e programit, Universiteti “Isa Boletini” dhe Graz University. Libri do të lansohet në një konferencë, e cila do të organizohet bashkërisht nga të gjithë partnerët.

**HERAS**  
Higher Education, Research  
and Applied Science Plus



With funding from  
Austrian  
Development  
Cooperation





## UIBM dhe Kolegji AAB koordinohen për projekte të përbashkëta

03.06.2021

Me datë 02.06.2021, është zhvilluar takim pune midis Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe Kolegjit AAB, me qëllim të jetësimit të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar muaj më parë. Në takim u diskutuan shumë tema më interes të përgjithshëm mirëpo, temat specifike ku u fokusua takimi dhe ku do të fokusohemi në javët dhe muajt në vazhdim janë: Koordinimi i një sesioni të përbashkët në kuadër të konferencës që do të zhvillohet në nëntor (2021) në Universitetin e Korçës, së bashku me Institutin Shqiptar të Sociologjisë (Tiranë) dhe institucionet të tjera partnere.

Në konferencën e radhës (ONLINE) që do të organizohet nga AAB, do të jetë partner i barabartë edhe Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë. U diskutua dhe u dakordua për dy ligjërata speciale për studentët e të dyja institucioneve që planifikohet të ndodhin shumë shpejtë dhe aktivitete të tjera të përbashkëta.

Në takim pune pjesëmarrës nga Universiteti “Isa Boletini”, në Mitrovicë ishin: Prof. Dr. Behxhet Shala, prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Hulumtime dhe Prof. Ass. Dr. Besim Gollopeni, dekan i Fakultetit të Edukimit ndërsa nga Kolegji AAB ishin Prof. Dr. Bujar Demjaha, rektor i Kolegjit AAB, Prof. Ass. Dr. Venera Lllunji, prorektore për Bashkëpunim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Dr. Sc. Uranela Demaj, prorektore për Shkence dhe Hulumtime dhe Ilirjana Geci, drejtoreshë për Zhvillim të Projekteve ERASMUS+.





## Marrëveshje për trajnimin e stafit akademik të UIBM në Qendrën për Përsosmëri në Mësimdhënie në UP

03.06.2021

Stafi akademik i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), do të shfrytëzojë kapacitetet e Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP), për fillimin e procesit të trajnimit. Për këtë qëllim të enjten u nënshkrua një Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet dy universiteteve nga rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj dhe rektori i UP-së, prof.dr. Naser Sahiti.

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi ka për qëllim të rregulloj mundësinë e trajnimit të personelit akademik të UIBM në Qendrën për Përsosmëri në Mësimdhënie (QPM) të UP-së, për të siguruar përsosmëri në mësimdhënie dhe avancimin e aftësive dhe kompetencave të personelit akademik të UIBM-së. Si e tillë ajo realizohet me kërkesë të rektorit Musaj, mbështetur edhe në marrëveshjen e vitit 2015 ndërmjet UP-së, UIBM-së dhe Ministrisë së Arsimit, sipas të cilës UP-ja do të ndihmojë UIBM në fushat akademike.

Rektori Musaj, e falënderoi homologun e tij nga UP-ja për gatishmërinë që të jetësohet ky bashkëpunim që ka të bëjë me trajnimin e stafit akademik në UIBM. Në anën tjetër, rektori Sahiti, u shpreh i lumtur që Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie mund të ndihmojë UIBM në këtë drejtim..

Në marrëveshje janë specifikuar detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, ku ndër të tjera parashihet që Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie (QPM) e UP-së, do të ofrojë trajnime në nivelin bazik dhe të avancuar për personelin akademik të UIBM-së. Në anën tjetër, UIBM përcakton listën e personelit akademik që do të jenë pjesëmarrës në trajnimet e organizuara nga QPM e UP-së.

Pas takimit, rektori i UP-së i cili shoqërohej edhe nga prorektorja për Bashkëpunim Ndërkombëtar, prof.asoc.dr. Albulena Blakaj, bashkë me nikoqirët vizituan kampusin universitar të UIBM.





## **Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në UP vizitoi FTU-në**

**08.06.2021**

Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës, Bedri Dragusha, ka vizituar Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, ku është njoftuar me të arriturat dhe kushtet e krijuara në këtë institucion akademik. Ai është takuar me dekanin e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore (FTU), Milaim Sadiku, ku është biseduar për ecurinë e projekteve në kuadër të Erasmus+ dhe projektit DualAFS, ku janë të përfshira këto dy fakultete.

Në takim kanë qenë të pranishëm edhe rektori i UIBM, Alush Musaj, kryesuesi i Këshillit Drejtues, Ali Topalli dhe anëtarë të tjerë të stafit akademik, të cilët e kanë vlerësuar bashkëpunimin ndërmjet njësive akademike nga dy universitetet. U potencua mundësia e shfrytëzimit të kapaciteteve të njërit apo tjetrit fakultet për hulumtime shkencore dhe punë praktike.

Dekani i FBV i shoqëruar nga stafi i UIBM ka vizituar hapësirat e FTU-së, si kabinetet, laboratorët etj, të cilat kanë krijuar kushte jashtëzakonisht të mira për studentë dhe mësime të mësimdhënës.





## Në kuadër të Projektit ResearchCult, në UIBM zhvillohet punëtorja për hartimin e Planit Strategjik Kërkimor 2021 – 2025

09.06.2021

Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, në kuadër të projektit ResearchCult, ERASMUS+ me datë 07 dhe 08.06.2021 u mbajt punëtorja për hartimin e Planit Strategjik Kërkimor 2021-2025 i UIBM. Në punëtori, përmes përfaqësuesëve të tyre morën pjesë të gjitha njësitë akademike. Punëtorja u moderuar nga Prof. Besim Gollopeni, Dekan i Fakultetit të Edukimit dhe njehërit koordinator i projektit ResearchCult për UIBM dhe Prof. Behxhet Shala, Prorektor për Bashkpunim Ndërkombëtar dhe Hulumtime. Në ditën e dytë të punëtorisë, draft Plani Strategjik Kërkimor 2021 – 2025 i UIBM-së iu prezantua Prof. Fiorenza Deriu, Universiteti Sapienza i Romës, Itali, të cilët gjithashtu janë pjesë e projektit ResearchCult. Meqë rast, Prof. Fiorenza dha komente dhe sugjerime rreth përmbajtjes dhe hartimit të Planit Strategjik Kërkimor. Deri në fund të muajit qershor pritet që të finalizohet Plani Strategjik Kërkimor i UIBM.





## **Përftohen djathëra speciale në laboratorët e FTU-së**

**10.06.2021**

**Në kuadër të punës praktike por edhe asaj hulumtuese që bëhet në laboratorët e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, studentet Djellza Zejnullahu dhe Fjolla Latifi të ndihmuara nga asistenti MSc. Arbër Hyseni përfantuan djathërat Halloumi, Requfort dhe Parmigiano Reggiano.**





## **UIBM merr pjesë në trajnimin për zhvillimin e projekt propozimeve dhe zhvillimit cilësor në kuadër të projektit QUADIC**

**11.06.2021**

Në datat 7-10 Qershor, Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë i përfaqësuar nga prorektorja për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe zhvillimin të cilësisë, Prof. Merita Shala dhe profesoresha e Fakultetit të Edukimit, Prof. Fatbardha Hoxha, ka marrë pjesë në trajnimin për zhvillimin e projekt propozimeve dhe zhvillimit cilësor në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe menaxhim, në kuadër të projektit QUADIC.

Në trajnim kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve partnere vendore dhe ndërkombëtare, disa prej të cilëve në lidhje direkte online për shkak të COVID-19.

Qëllimi kryesor i trajnimit ishte ngritja e kapaciteteve për bashkëpunim ndërkombëtar dhe hartim të projekt propozimeve. Përveç prezantimeve nga koordinatorët e projektit, diskutimet në grupe rreth ideve për projekte të përbashkëta, rolit dhe përgjegjësi të partnerëve në këto projekt-ide, janë prezantuar dhe diskutuar detajisht, si parapërgatitje për thirrjet e radhës për projektet e Erasmus+.





## **Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të projektit për mobilitet nga Erasmus+**

**11.06.2021**

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) dhe Universiteti “Ita Suomen Yliopisto” nga Finlanda janë pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në kuadër të projektit Erasmus + për mobilitet të studentëve dhe stafit akademik. Një ndër pikat e veçanta që potencohet në marrëveshjen e bashkëpunimit ka të bëjë me njohjen e kredive apo vlerave ekuivalente të studentëve nga institucionet partnere.

Në kuadër të shkëmbimeve të studentëve dhe stafit akademik janë përfshirë të gjitha fushat e studimit në këto dy institucione akademike. Poashtu pjesë e mobilitetit mund të bëhen studentët të gjitha niveleve, të cilët do të mund të qëndrojnë nga 3 muaj në institucionin partner.

Rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, tha se kjo është edhe një mundësi tjetër për studentët dhe stafin akademik. “Projektet e bashkëpunimit dhe në këtë rast ato që ndërlihen me Programin Erasmus+ janë duke hapur dritare të reja që duhet të shfrytëzohen nga studentët dhe mësimdhënësit”, tha ai.





## Organizata KUSA ofron mbështetje për UIBM

16.06.2021

Organizata KUSA do të ofroj mbështetje për Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) për përgatitjen e projekteve që kanë të bëjnë me Programin Garues të Mbështetjes së Universiteteve nga Ambasada Amerikane në Kosovë. Lidhur me detajet që kanë të bëjnë me këtë program, të mërkurën u zhvillua një takim ndërmjet rektorit, prof.dr.Alush Musaj dhe drejtorit ekzekutiv të organizatës KUSA, Labinot Salihu si dhe asistentes së programit edukativ, Rina Bulliqi.

Drejtuesit e KUSA-së (organizatë jofitimprurëse e cila mbështetet nga Ambasada e Amerikës), theksuan se janë tri objektiva që synohet të arrihen në kuadër të programit për mbështetjen e universiteteve. Këto tri objektiva sipas tyre janë: Bashkëpunimi për rritjen e qasjes së studentëve në projekte, rritjen e aplikimit të studentëve dhe mbështetja për universitetet sa i përket programeve të ndërlidhura me tregun e punës.

Rektori Musaj, i cili në takim shoqërohej edhe nga prorektorët, prof.ass.dr.Merita Shala e prof.ass.dr.Ajtene Avdullahi, falënderoi mysafirët për mundësinë e ofruar për UIBM. “Jemi shumë mirënjohës për mbështetjen tuaj dhe do të mobilizohemi që të bëhemi pjesë e programit tuaj me projektet tona”, tha ai.





## **Biblioteka “Latif Berisha” ndihmon me libra Bibliotekën Universitare**

**16.06.2021**

**Biblioteka Ndërkomunale “Latif Berisha” në Mitrovicë ka dhuruar një fond librash për Bibliotekën e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Me këtë rast rektori, prof.dr.Alush Musaj dhe zv.drejtoresha e Bibliotekës “Latif Berisha”, Mejreme Xhemajli, kanë vizituar Bibliotekën Universitare për të parë kushtet e punës dhe fondin librar.**

**Rektori Musaj e ka falënderuar drejtoreshën për mbështetjen me libra dhe ka shprehur interesim për rritjen e bashkëpunimit me Bibliotekën “Latif Berisha”. “Librat që keni dhuruar për Bibliotekën Universitare, do të pasurojë fondin librar, të cilat do të jenë në dispozicion të studentëve, stafit akademik dhe gjithë qytetarëve që duan t’i shfrytëzojnë ato”.**

**Ndërsa, zv.drejtoresha, u shpreh e mahnitur me kampusin e ri universitar dhe kushtet e Bibliotekës Universitare. “Ajo që pashë këtu është e jashtëzakonshme sa i përket kushteve dhe mundësive që ofroni për studentët dhe të gjithë ata që duan të shfrytëzojnë mundësitë që ofrohen”.**

**Të dy palët u dakorduan që të thellojnë bashkëpunimin sa i përket ruajtjes, sistemimit dhe regjistrave të librave sipas praktikave të fundit.**





## Këshilli Organizativ i Konferencës së Tretë Ndërkombëtare Multidisciplinare të Gjeoshkencave mban takimin e radhës

16.06.2021

Këshilli Organizativ i Konferencës së Tretë Ndërkombëtare Multidisciplinare të Gjeoshkencave IMGC2021 mbajti takim pune në të cilën u diskutua rreth organizimit të konferencës.

Këshilli vendosi që të zgjas afatin e pranimit të abstrakteve deri më 30 Qershor 2021.

Në këtë takim gjithashtu u vendos që në kuadër të konferencës, në ditën e dytë të organizohet vizitë në terren.





## “Herasi” vazhdon mbështetjen për UIBM

21.06.2021

Në kuadër të mbështetjes për Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), “Herasi” ka organizuar një punëtori dy ditore me temë: Monitorimi, raportimi dhe evaluimi i dokumenteve strategjike të UIBM. Në mesin e grupit që morën pjesë në trajnim përveç menaxhmentit dhe administratës, kishte edhe mësimdhënës, studentë dhe përfaqësues të organizatave dhe institucioneve partnere.

Rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, e ka falënderuar “Herasin” për mbështetjen sa i përket trajnimit, por edhe projekteve të tjera që po realizohen bashkërisht. “Jemi shumë të kënaqur me punën e përbashkët dhe për ekspertizën e ofruar nga ekspertët e “Herasit” në shumë fusha”, tha ai.

Së shpejti pritet që ekspertët e kësaj organizate të ofrojnë ndihmën e tyre edhe për rishikimin e dokumenteve kryesore të UIBM, për të krijuar një standard të qëndrueshëm edhe në të ardhmen.





## Studentët e Informatikës Inxhinierike fitues të garës për siguri kibernetike

22.06.2021

Studentët e Informatikës Inxhinierike në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (FIMK) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), kanë zënë vendin e parë në garën për siguri kibernetike “Kosovo Cyber Challenge”. Në këtë garë të organizuar nga UNDP-ja në bashkëpunim me Women4Cyber Albania, Telelink Business Services dhe IPKO Foundation, kanë marrë pjesë tre studentë nga FIMK-u: Eron Mahmuti, Valton Tahiri dhe Armend Binaku.

Fituesit janë shpërblyer me tabletë dhe praktike pune ne Women4Cyber Albania. Shpërblimet janë ndarë nga Maria Skuokku, përfaqësuese e Përhershme e UNDP-së në Kosovë, e cila i ka uruar për suksesin e arritur

Ndryshe, studentët e Departamentit Informatikë Inxhinierike nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (FIMK), ditë më parë kanë zënë vendin e parë edhe në garën “Hackathon” të llojit Capture the Flag. Shefi i departamentit, profesori Berat Ujkani, u shpreh i lumtur me sukseset e studentëve të UIBM-së, të cilët po tregohen shumë të shkathët në profesionin e tyre dhe njëkohësisht po i bëjnë nder institucionit.





## **Themelohet “Instituti për Studime dhe Hulumtime Juridike e Ligjore” dhe “Instituti i Gjeoshkencave”**

**23.06.2021**

**Pas themelimit të “Institutit për Studime dhe Hulumtime Juridike e Ligjore” (ISHJL) në kuadër të Fakultetit Juridik (FJ), Këshilli Drejtues i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), në mbledhjen e fundit ka marrë vendim edhe për themelimin e Institutit të Gjeoshkencave në kuadër të Fakultetit të Gjeoshkencave (FGJ). Gjithashtu janë miratuar edhe rregulloret e këtyre instituteve.**

**Rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, tha se këto dy institute janë dëshmi e punës së mirë që po bëhet nëpër fakultete. “Konsolidimi i UIBM ka krijuar mundësi që fokusi të orientohet krejtësisht në punën kërkimore e shkencore, duke përfshirë në këtë rast edhe krijimin e këtyre instituteve”.**

**Qëllimi i Institutit për Studime dhe Hulumtime Juridike e Ligjore, sipas rregullores së miratuar është përkrahja dhe avancimi i zhvillimit të hulumtimeve dhe studimeve juridike e ligjore. Gjithashtu nënvizohet zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës për veprimtaritë juridike e ligjore.**

**Sa i përket veprimtarisë, Instituti për Studime dhe Hulumtime Juridike e Ligjore, ndër të tjera do të realizojë këto aktivitete: realizimin dhe mbështetjen e hulumtimeve juridike dhe ligjore, do të promovojë studimet ndërdisiplnare, të përgatis analiza dhe ekspertizë juridike dhe ligjore për nevoja të institucioneve publike dhe shtetërore.**





## **Takim monitorues për projektin “Drejt një sistemi të orientuar për cilësi të arsimit fillestar për të rritur profesionalizmin e mësuesve në Kosovë-QATEK”**

**25.06.2021**

Më 25 qershor 2021, Prorektorja për Mësimdhënie, Çështje të studentëve dhe Zhvillim të Cilësisë prof. ass. dr. Merita Shala, së bashku me përfaqësueset e Fakultetit të Edukimit, Prof. Fatbardha Hoxha dhe Prof. Albana Sadiku, kanë pritur në takim znj. Jehona Lushaku Sadriu, Koordinatorë e zyrës së Erasmus+ në Kosovë dhe znj. Blerina Zjaqa, zyrtare në Erasmus+.

Qëllimi i takimit kishte karakter monitorues për projektin “Drejt një sistemi të orientuar për cilësi të arsimit fillestar për të rritur profesionalizmin e mësuesve në Kosovë-QATEK” (QATEK- Towards Quality Oriented System of Initial Teacher Education to Increase Teacher Professionalism in Kosovo) duke u fokusuar në aktivitetet e realizuara dhe produktet e zhvilluara deri më tani.

Prorektorja Shala, gjatë takimit i ka njoftuar përfaqësueset e zyrës së Erasmus+, rreth aktiviteteve, të arriturat e deritanishme, planet dhe sfidat me të cilat po përballen në implementimin e këtij projekti në Fakultetin e Edukimit në UIBM. Fokusi u vendos në përfitimet e programit, studentëve dhe stafit nga angazhimi në këtë projekt.

Ndërsa, përfaqësueset nga zyra e Erasmus + në Kosovë, pas bisedës së frytshme, siguruan vazhdimësinë e mbështetjes për realizimin sa më me sukses të këtij projekti.





## Ministrja Nagavci takoi rektorët e universiteteve publike

30.06.2021

Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof.dr. Alush Musaj, ka marrë pjesë në një takim me ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, e cila ka pritur rektorët e universiteteve publike, ku është biseduar për gjendjen në arsimin e lartë. Ajo është shprehur se miratimi i Ligjit të ri për Arsimin e Lartë dhe infrastrukturës përcjellëse është një nga prioritetet e Qeverisë.

Gjithashtu në takim u fol edhe për nevojën e përmirësimit të infrastrukturës, në mënyrë që të ketë shërbime më të mira për studentët. Poashtu u potencua domosdoshmëria e koordinimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë për ngritjen e cilësisë në arsim.

Një çështje tejet me rëndësi që u shtrua në takim ishte edhe rishikimi i sistemit të financimit dhe profilizmi i universiteteve publike. Ministrja Nagavci shprehu gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar më udhëheqësit e këtyre institucioneve në kërkesat e tyre si: krijimi i mundësisë unike për qasje në literaturë, funksionalizmi i sistemit antiplagjiaturë, krijimi i rrjetit bibliotekar dhe çështje të tjera.

Zëvendësministri Dukagjin Pupovci, prezantoi programin qeverisës që ndërlidhet me arsimin e lartë dhe me punën kërkimore-hulumtuese dhe inovacionin.





## Senati zgjodhi katër anëtarë të Këshillit Drejtues nga stafi akademik

30.06.2021

Senati i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), në mbledhjen IV/2021, që u mbajt të mërkurën (30 qershor 2021), ka zgjedhur katër anëtarë të Këshillit Drejtues (KD). Anëtarët e zgjedhur nga stafi akademik janë: Prof. dr.sc. Valdet Gjinovci, Prof.ass.dr. Ylber Januzaj, Msc.Fatbardha Hoxha, Phd dhe Prof.dr.sc. Halil Bajrami.

Sipas Statutit të ri, Këshilli Drejtues i UIBM, përbëhet prej 7 anëtarëve, 4 prej të cilëve zgjedhën nga stafi akademik dhe 3 të tjerë emërohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Përderisa Senati ka zgjedhur 4 anëtarët e rinj, 3 të tjerë pritet të emërohen nga MASHTI. Përbërja e re e KD-së e merr detyrën më 1 tetor 2021.

Në këtë mbledhje u aprovua edhe Rregullorja për punën e Senatit si dhe u mor vendimi për përcaktimin e kriterëve për konkursin për pranimin e studentëve të rinj në nivelin bachelor dhe master për vitin akademik 2021/22.





